3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paoftuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shoqëria Albepetrol sh.a ushtron aktivitetin e nxjerrjes së naftës në vendburimet që ka në administrim Kuçovë, Patos, Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Amonicë dhe Karbunarë. Aktualisht këto vendburime ndodhen në stadë të avancuar të shfytësimit ku meqënëse presioni i shtresës është i pamjaftueshëm për nxjerrjen e fluidit në sipërfaqe, teknologjia më e përshtatshme e shfrytëzimit është ajo me pompë thëllësie (me lëkundës, PCP, Jet-pompë, lëkundës kameron) etj. Teknologjia e nxjerrjes së naftës me Jet pompë është teknologji të cilën Albpetroli e trashëgoi pas marrjes së vendburimit Cakran –Mollaj nga shoqëria Strem Oil & Gaz (me pas Transatlantik Albania ltd) në shkurt të vitit 2017 pas prishjes së Marëveshjes Hidrokarbure “Per zhvillimin dhe nxjerrjen e Hidrarkbureve në Vendburimin Cakran –Mollaj” lidhur me këtë shoqëri në vitin 2007. Kompletimi i puseve që shfrytëzohen me këtë teknologji ka në përbërje të tij paisjen “Packer” i cili ulet në pus me tubot pompë-Komresor dhe bën të mundur ndarjen e hapësirës kezing-tubing ku në tubing injektohet ujë teknologjik me presion deri në 3000 PSI dhe nëpërmjet jetit fluidi që vjen nga shtresa del në kezing e më tej në rezervuarët e qendrave të prodhimit.

Në Sektorin Cakran – Mollaj të QPN Fier vazhdojnë të jenë në shfrytëzim pusët me Jet- Pompë të cilët për nga rëndësia e prodhimit të këtyre puseve zënë një vend të konsiderueshëm në realizimin e prodhimit të programuar në këtë vendburim. Aktualisht në shfrytëzim janë pusët:

Në Qendrën 29 shfrytëzohen pusët Ca-57 dhe Ca-62 me Jet-Pompë.

Pusi Ca-57 është i pajisur me Paker Φ 5-1/2” me sistem kunjosje të dyfishtë (Kunjosje dhe lart dhe poshtë). Pakeri në këtë pus nuk është zëvendësuar në 2 ndërhyrjet e fundit të remontit nëntokësor por thjesht është zërthyer dhe mirëmbajtur (Zëvendësim gominash, sustash etj.). Zërthimi i pakerit kryhet me mjete krahu (Celës papagall, varre, çelës katen etj.) pasi nuk mund të kryhet me mjete teknologjike. Në procedurën e radhës të remontit nëntokësor nuk është e sigurtë që pakeri që do të dali nga pusi mund të ripërdoret përsëri pasi nuk mund të parashikohet shkalla e dëmtimit që mund të ketë pësuar kjo pajisje në pus ose mund të pësojë dëmtim të pa riparueshëm gjatë procesit të nxjerrjes nga pusi dhe të riparimit të tij. Kjo do të sillte një situatë ndalesë të menjëhershme të prodhimit në pusin Ca-57 pasi pakeri luan rolin kryesor (Hermetizimin tubing-kezing) në sistemin Jet-Pomp dhe në magazinat e kompanisë Albpetrol Sh.a nuk ka pajisje që mund ta zëvendësojnë. Për këtë arsye lind nevoja që të ketë të paktën 1 (Një) njësi (Cop) rezervë në magazineë

Pusi Ca-62 është i pajisur me Paker Φ = 5” me sistem kunjosje të dyfishtë (Kunjosje dhe lart dhe poshtë). Pakeri në këtë pus nuk është zëvendësuar në 3 ndërhyrjet e fundit të remontit nëntokësor por thjesht është zërthyer dhe mirëmbajtur (Zëvendësim gominash, sustash etj.). Zërthimi i pakerit kryhet me mjete krahu (Celës papagall, varre, çelës katen etj.) pasi nuk mund të kryhet me mjete teknologjike. Në procedurën e radhës të remontit nëntokësor nuk është e sigurtë që pakeri që do të dali nga pusi mund të ripërdoret përsëri pasi nuk mund të parashikohet shkalla e dëmtimit që mund të ketë pësuar kjo pajisje në pus ose mund të pësojë dëmtim të pa riparueshëm gjatë procesit të nxjerrjes nga pusi dhe të riparimit të tij. Kjo do të sillte një situatë ndalesë të menjëhershme të prodhimit në pusin Ca-57 pasi pakeri luan rolin kryesor (Hermetizimin tubing-kezing) në sistemin Jet-Pomp dhe në magazinat e kompanisë Albpetrol Sh.a nuk ka pajisje që mund ta zëvendësojnë. Për këtë arsye lind nevoja që të ketë të paktën 1 (Një) njësi (Cop) rezervë në magazinë.

Në Qendrën 25 shfrytëzohet pusi Ca-34 me Jet-Pompë.

Pusi Ca-34 është i pajisur me Paker Φ = 5-1/2” me sistem kunjosje të dyfishtë (Kunjosje dhe lart dhe poshtë). Ashtu si edhe në pusin Ca-57 në 2 punimet e kryera nuk është ulur pakeri i ri por është riparuar

në QMN Kuçovë. Për këtë arsye lind nevoja që të ketë të paktën 1 (Një) njësi (Cop) rezervë në magazinë.

Për mos ndotjen e mjedisit (ku ndotja e tij konsiderohet krim e dënohet me ligj) nga ujrat shtresorë që nxiren nga vendburimet e naftës të cilët përmbajnë mbeturina naftë gazi H₂S si dhe kripëra, në vendburimet Cakran –Mollaj, Amonicë e Gorisht –Kocul janë pusët e kthyer në puse të injektimit të ujit shtresor.

Pusët e injektimit të ujit si Am-44, Ca-32, Ca-38, Ca-21, Mo-34, Go-14, Go-28, Go-29 dhe Go-30 kanë nevojë për pakera që të bëjë izolimin e hapsirës unazore (Tubing-Kezing) me synim mbrojtjen e kezingut nga efekti korroziv që ka uji i shtresës (Ujë me kripëra) dhe mbrojtjen nga acidi gjatë përpunimit me acid të këtyre puseve. Kjo do të sjelli rritjen e jetëgjatësinë së kollonave të këtyre puseve.

Dekantimi Amonicë injekton të gjithë ujin teknologjik në pusin Am-44. Dalja jashtë funksioni e këtij pusi do të sillte ndalimin e menjëhershëm të punës në vendburimin Amonicë prandaj duhet përdorur paker në këtë pus për të mbrojtur kollonën e shfrytëzimit dhe zgjatur jetëgjatësinë e pusit.

Dekantimi Gorisht duhet të injektojë të gjithë ujin teknologjik në pusët Go-14, Go-28, Go-29 dhe Go-30. Aktualisht në këtë vendburim uji shtresor injektohet vetëm në pusin Go-28. Pusi Go-29 është pajisur me paker ndërsa pusi Go-14 dhe Go-28 nuk janë të pajisur me paker. Dalja jashtë funksioni e pusit Go-28 do të sillte ndalimin e punës në vendburimin Gorisht prandaj duhet marrë masat për përdorimin e pakerit në pusin Go-28 për të mbrojtur kollonën e shfrytëzimit dhe zgjatur jetëgjatësinë e pusit si dhe vendosjen në funksion të puseve të tjerë për injektimin e ujit shtresor pasi sasia e ujit është relativisht e lartë e rendit 8000-10000 m³në muaj.

Vendburimi Cakran-Mollaj e injekton ujin teknologjik që vjen në Qendrën 17 në pusin Ca-32. Dalja jashtë funksioni të këtij pusi do të sillte ndalimin e menjëhershëm të punës në vendburimin Cakran-Mollaj prandaj duhet përdorur paker në këtë pus për të mbrojtur kollonën e shfrytëzimit dhe zgjatur jetëgjatësinë e pusit.

Në Qendrën 29 në Vendburimin Cakran e injekton ujin teknologjik në pusin Ca-21. Dalja jashtë funksioni të këtij pusi do të sillte problematika si për këtë grup ashtu edhe në Qendrën 25, dhe Qendrën 38. Kjo do të sillte rritjen e mundësive për avari të linjave të pompimit të gjithë këtyre qendrave dhe do ta ngarkonte së tepërmi Qendrën 17 me ujë të pa nevojshëm duke vënë në provë kapacitete magazinuese. prandaj duhet përdorur paker në këtë pus për të mbrojtur kollonën e shfrytëzimit dhe zgjatur jetëgjatësinë e pusit.

Pusët Ca-57, Ca-62, dhe Ca-34 kanë prodhim të konsiderueshëm dhe përbëjnë rreth 35% të gjithë prodhimit të vendburimit Cakran-Mollaj ndërsa pusët e injektimit sigurojnë mbarëvajtjen e punës duke hequr ujin e tepërt të dalë nga procesi i trajtimit dhe e injektojnë në pus.

Gjatë shfrytëzimit të puseve të naftës në vendburime të ndryshme nga koha e gjatë periudhe 50-60 vjeçare kollonat e shfrytëzimit pësojnë defekte(çarje) të cilat çojnë në përmbytjen e pusit nga uji dhe argjilat dhe ndërprerje të ardhjes së naftës nga shtresat produktive. Një nga metodat më efikase për izolimin e këtyre ujrave apo argjilës është metoda e uljes së pakerave me tubot pompë -kompresorë dhe riaktivizimi i pusit për nxjerrjen e naftës.

Disa puse prodhimi në QPN Gorisht si Go-190, Am-76, Am -77 kanë kaluar në 100 % ujë dhe ardhje argjile, kjo ka ndodhur si pasojë e ardhjes e ujrave të ëmbëla dhe argjilës nga shtresat e sipërme nga çarja e kollonës së shfrytëzimit, për të bërë izolimin e këtyre shtresave mendohet të ulen pakera Ø6 5/8”.

Nevojat për pakera të Qendrave të prodhimit janë të larta por në programin e Zhvillimit Ekonomik të vitit 2025 është programuar të blihen 5 (pesë) copë pakera mekanik sipas tableës së mëposhtme:

Nr	Paker mekanik	Copë	5
1	Paker mekanik pusi Ø5"	Copë	1
2	Paker mekanik pusi Ø5 1/2"	Copë	1
3	Paker mekanik pusi Ø6 5/8"	Copë	3

Në vazhdim lutem gjeni specifikimet teknike për materialet paker mekanik pusi.

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR PAKERA MEKANIK

1. PËRSHKRIMI TEKNIK I PËRGJITHSHËM

Kjo procedure prokurimi ka për qëllim furnizimin dhe dorëzimin e pakerave mekanik për përdorim në industrinë e naftës dhe gazit, konkretisht në operationet në puse vertikale ose deviacionale, për qëllime të izolimit të formacioneve, testimeve të presionit, acidizimit ose trajtimeve stimuluese. Pakeri është një komponent thelbësor për mbylljen e kontrolluar të pjesëve të caktuara të vrimës së pusit, duke mundësuar operatione të sigurta dhe të efektshme.

Pakerët duhet të jenë të projektuar për të ofruar një mbyllje të fortë mekanike dhe të kenë forcë të lartë mbajtëse në tubacion. Aktivizimi (pakerimi apo shpakerimi) i tyre duhet të realizohet përmes aplikimit të një çifti rrotullues ose të një lëvizësi aksial, **duke patur dy palë kunjë, të poshtme për pakerimin dhe të sipërme për mos shpakerimin nga presioni i poshtëm.** Elementi i vulosjes (hermetizimit) duhet të jetë i përbërë nga material elastomërik i përzgjedhur për rezistencë të lartë ndaj kimikateve, presioneve ekstreme dhe temperaturave të larta.

Të gjitha komponentët(elementët) duhet të jenë të fabrikuar sipas standardeve ndërkombëtare API ose ekuivalente me të dhe të përballojnë kushte ekstreme shërbimi pa deformim ose humbje të vetive teknike. Pakerët duhet të jenë të rikthyeshëm dhe të lehtë për mirëmbajtje.

Për secilin model të pakerit, duhet të paraqitet skica teknike e detajuar me të gjithë elementet e tij, skema e montimit dhe udhëzuesi i përdorimit. Gjithashtu, prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas kërkesave të standartit API ose ekuivalent me të për elementet e puseve të naftës dhe të vërtetohen nëpërmjet certifikatave përkatëse.

2. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETAJUARA SIPAS PËRMASAVE.

◆ 2.1 Paker Mekanik Ø5"

Parametri	Vlera
Diametri nominal i tubit	5.00 inç
Diametri i jashtëm	Jo më i vogël se 4.23 inç
Diametri i brendshëm	Jo më i vogël se 2.25 inç
Gjatësia totale	Jo më e vogël se 1720 mm

Presioni maksimal i punës	Duhet te jete jo me i vogel se 520 bar
Temperatura e punes	Duhet te rezistoje te pakten deri ne 145°C
Materiali i trupit	42CrMo4 ose ekuivalent me te
Materiali i elementit elastomeric (gominat)	Gome butadieni e hidrogjenizuar ose ekuivalente me te
Mekanizmi i aktivizimit	Te jete i pajisur me komplet mekanik me rotacion ose me rrëshqitje
Kapaciteti i mbajtjes së ngarkesës	Te pakten 263 kN
Lloji i filetimit fundor	Jo me i vogel se 60.3mm EUE

◆ 2.2 Paker Mekanik Ø 5 1/2”

Parametri	Vlera
Diametri nominal i tubit	5.50 inç
Diametri i jashtëm	Jo me i vogel se 4.71 inç
Diametri i brendshëm	Jo me i vogel se 2.47 inç
Gjatësia totale	Jo me e vogel se 1835 mm
Presioni maksimal i punës	Duhet te jete jo me i vogel se 550 bar
Temperatura e punes	Duhet te rezistoje te pakten deri ne 154°C
Materiali i trupit	42CrMo4 ose ekuivalent me te
Materiali i elementit elastomeric (gominat)	Gome butadieni e hidrogjenizuar ose ekuivalente me te
Mekanizmi i aktivizimit	Te jete i pajisur me komplet mekanik me rotacion ose me rrëshqitje
Kapaciteti i mbajtjes së ngarkesës	Te pakten 330kN
Lloji i filetimit fundor	Jo me i vogel se 65.9 mm EUE ose IF

◆ 2.3 Paker Mekanik Ø 6 5/8”

Parametri	Vlera
Diametri nominal i tubit	6.625 inç

Diametri i jashtëm	Jo me i vogel se 5.63 inç
Diametri i brendshëm	Jo me i vogel se 2.84 inç
Gjatësia totale	Jo me e vogel se 1880 mm
Presioni maksimal i punës	Duhet te jete jo me i vogel se 690 bar
Temperatura e punes	Duhet te rezistoje te pakten deri ne 175°C
Materiali i trupit	42CrMo4 ose ekuivalent me te
Materiali i elementit elastomeric (gominat)	Gome butadieni e hidrogjenizuar ose ekuivalente me te
Mekanizmi i aktivizimit	Te jete i pajisur me komplet mekanik me rotacion ose me rrëshqitje
Kapaciteti i mbajtjes së ngarkesës	Te pakten 396kN
Lloji i filetimit fundor	Jo me i vogel se 78.6 mm EUE ose IF

-Pakerat që do të ofrohen duhet të shoqërohen me elementë elastomeric (gominat e hermetizimit) rezervë të paktën me dy (sete për çdo model), sipas modeleve të pakerave:

Për pakerat Mekanik Ø5” përmasa e gominave të jetë për kolona shfrytëzimi me peshë 15-20 lb/ft.

Për pakerat Mekanik Ø 5 1/2” përmasa e gominave të jetë për kolona shfrytëzimi me peshë 17-23 lb/ft.

Për pakerat Mekanik Ø 6 5/8” përmasa e gominave të jetë për kolona shfrytëzimi me peshë 20-32 lb/ft.

-Gjithashtu pakerat që do të ofrohen duhet të shoqërohen me të paktën me dy sete rezervë guarnicione apo premistopë të brendshëm (për çdo model) sipas përmasave të secilit paker.

- Pakerat duhet të jenë ambalazhuar në arka dërrase ku të jenë stampuar përmasa e pakerit, vendi i origjinës nga vjen malli, si dhe adresa ku shkon malli Albpetrol sh.a.

Kudo ku janë përmendur standartet ndërkombëtare, do të pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve ndërkombëtare dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr	Paker mekanik	Copë	5
1	Paker mekanik pusi Ø5"	Copë	1
2	Paker mekanik pusi Ø5 1/2"	Copë	1
3	Paker mekanik pusi Ø6 5/8"	Copë	3

Afatet e lëvrimit:

Malli objekt prokurimi do të levrohet jo më vonë se 20 ditë nga lidhja e kontrates. Furnizuesi duhet të dorëzojë mallin objekt prokurimi pranë magazinave të Autoritetit Kontraktor në QFT Patos ku do të merret në dorëzim nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mallit i ngritur me urdher të posacem.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriteve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

-
- 2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për pervojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

OSE

Në rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikaten ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skede teknike nga prodhuesi, për pajisjen objekt të prokurimit. Katalogu/Skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të pajisjes objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse pajisja e ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/skedën teknike të paraqitur të shenjohen në mënyrë të dukshme të gjitha specifikimet teknike të pajisjes së ofruar. (Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike ku jepen karakteristikat e pajisjes që ofrohet nëq nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).
- 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë skemë teknike për instalimin dhe mënyrën e operimit të pakerave, të lëshuar nga prodhuesi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMbledhës I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005). Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.
Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
